



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:275374  
Datë: 23.05.2024  
Numri i dokumentit: 05724808

AA.nr.611/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, F.B nga Prishtina, të cilin e përfaqëson me autorizim, Yll Zekaj, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, përkitazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1605/19, të datës;25.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;20.05.2024, merr këtë,

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1605/19, i datës;25.04.2023, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1605/19, të datës;25.04.2023, është vendosur, “*I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.B nga Prishtina. II. ANULOHEN si të kundërligjshme vendimet e të paditurës, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës Nr.prot. 621/4 i datës 17.06.2019 si dhe vendimi i shkallës së parë Nr.02/2019 i datës 21.05.2019. III. OBLIGOHET e paditura Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, që paditëses F.B nga Prishtina, t’ia paguajë shumën prej 10,029.00 (dhjetëmijë e njëzet e nëntë) Euro, në emër të shpenzimeve për Trajtim Mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, të gjitha këto brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor. IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.”*

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të

aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës dhe aktgjykimi i goditur të ndryshohet ose i njëjti të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala paditëse.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë:05.07.2019, kundër vendimit të paditurës, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, me çka kërkuar nga Gjykata që të anulohet vendimin e të paditurës nr.621/4 i datës;17.06.2019 me të cilin i është refuzuar ankesa lidhur me kompensimin e mjeteve për trajtimin e kryer në institucionin shëndetësor jashtë institucioneve publike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe i propozon Gjykatës që padinë ta aprovojë si të bazuar, vendimin e të paditurës ta anulohet, paditëses t'i njihet e drejta në kompensimin e mjeteve për trajtimin e kryer në institucionin shëndetësor si dhe të gjitha shpenzimet procedurale.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses të paraqitur kundër vendimit të paditurës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetim se *“Nga shkresat e lëndës, konstatohet se paditësja me datën 08.01.2019 - 01.02.2019 është mjekuar në Spitalin Special për Kirurgji “Zh...”, në Shkup, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore. Në bazë të faturave me nr.7280/2019 i datës 01.02.2019, nr.10862/2019 e datës 14.02.2019, nr.2027/2019 të datës 11.01.2019, nr.13369/2019 e datës 23.02.2019, 16264/2019 e datës 06.03.2019, 7279/2019 e datës 01.02.2019, 36/2019 i dt.09.01.2019, urdhërpagesa ndërkombëtare nr.8211537 e datës 10.01.2019, vërtetohet se paditësja ka paguara gjithsej shumën prej 10,029.00 (dhjetë mijë e njëzet e nëntë) Euro. Me datën 19.03.2019 paditësja ka parashtruar kërkesën për kompensim të mjeteve për trajtim shëndetësor jashtë institucioneve publike shëndetësore, me ç'rast Komisioni Mjekësor në takimin e mbajtur me datë 21.05.2019 ka refuzuar kërkesën e paditësit me arsyetimin se e njëjta ka marrë iniciativën individuale dhe ka filluar trajtimin mjekësor pa përfunduar në tërësi procedurat administrative sipas dispozitave të nenit 4 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ. Paditësja kishte ushtruar ankesë kundër vendimit të Komisionit Mjekësor pranë të paditurës e cila me vendimin kontestues e kishte refuzuar ankesën si të pabazuar. Paditësja e pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka parashtruar padi për hapjen e konfliktit administrativ duke kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe rekomandimeve sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.1085/2021 të datës 04.10.2022, ku gjeti se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar. Për të vlerësuar padinë e paditëses gjykata fillimisht ju referua Udhëzimit Administrativ Nr.03/2017 për trajtim mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, konkretisht nenit 5 par.1 të këtij udhëzimi i cili përcakton procedurën që duhet zhvilluar për aplikim në rastet emergjente si dhe kushtet që duhet plotësuar. Është fakt i pakontestueshëm se paditësja ka filluar trajtimin jashtë institucioneve shëndetësore publike, pa përfunduar të gjitha procedurat administrative siç përcaktohen me dispozitat e lartcekura. Në anën tjetër, në bazë të fakteve notore, vërtetohet se institucionet në periudhën në të cilën u është drejtuar paditësja, kanë qenë në grevë, ashtu që punëtorët shëndetësorë nuk kanë ofruar shërbime shëndetësore. Nga kjo del se paditësja ka qenë e penguar pa fajin e saj, që të ndjek procedurat*

*administrative siç përcaktohet me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2017. Po ashtu, në bazë të shkresave të lëndës, vërtetohet se gjendja shëndetësore e paditëses ka qenë e rëndë dhe se trajtimi i saj në kohë, ka qenë i detyrueshëm. Në këtë kuptim, gjykata duke marr parasysh të lartcekurat si dhe provat në shkresat e lëndës, konkretisht urdhërpagesave Nr.8211537 si dhe urdhërpagesën e datës 09.01.2019, vërtetoi se paditësja ka paguar shumën prej 10,029.00 €, në emër të shpenzimeve për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike, andaj edhe vendosi që të obligojë të paditurën që t'i bëjë kompensimin e këtyre shpenzimeve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.”*

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimit ankimor se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditura të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë, përkatësisht, nuk ka specifikuar asnjë dispozitë konkrete se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të LPPA-së, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se e paditura në ankesë edhe kësaj shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, kjo për faktin se bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata e shkallës së parë konstaton se është fakt i pakontestueshëm se paditësja ka filluar trajtimin jashtë institucioneve shëndetësore publike, pa përfunduar të gjitha procedurat administrative siç përcaktohen me dispozitat e lartcekura. Në anën tjetër, në bazë të fakteve notore, vërtetohet se institucionet në periudhën në të cilën u është drejtuar paditësja për trajtim shëndetësor, kanë qenë në grevë, ashtu që punëtorët shëndetësorë nuk kanë ofruar shërbime shëndetësore. Nga kjo del se paditësja ka qenë e penguar pa fajin e saj, që të ndjek procedurat administrative siç përcaktohet me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2017. Po ashtu, në bazë të shkresave të lëndës, vërtetohet se gjendja shëndetësore e paditëses ka qenë e rëndë dhe se trajtimi i saj në kohë, ka qenë i detyrueshëm. Po ashtu Gjykata e shkallës së parë duke marr parasysh të lartcekurat si dhe provat në shkresat e lëndës, konkretisht urdhërpagesave Nr.8211537, si dhe urdhërpagesën e datës;09.01.2019, vërtetoi se paditësja ka paguar shumën prej 10,029.00 €, në emër të shpenzimeve për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike, andaj edhe vendosi që të obligojë të paditurën që t'i bëjë kompensimin e këtyre shpenzimeve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, pasi që e paditura me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e saj ankimore, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu vendimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale, konkretisht në nenin 5 paragraf 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2017 për trajtim mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike.

Mbi këto arsye kolegji i apelit këto pretendime ankimore i konsideron si të pa bazuara, prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, dhe mbi këtë bazë ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
AA.nr.611/2023, datë;20.05.2024

Kryetari i kolegjit,  
Hajriz Hoti